



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 818 Prot.

Tiranë, më datë 17.08.2020

**VENDIM**

**Nr. 273, datë 17.08.2020**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 17.08.2020,

**VENDOSI:**

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin “Restaurim Fasade i objektit “Federata e Familjes për Paqe Botërore dhe Bashkim” Korçë, Rruga “Kongresi i Përmetit”, Lagjja 2, me autor person i licencuar në restaurim Ing. Dhimitër Kondakçi, me aplikues Federata e Familjes për Paqe Botërore dhe Bashkim;
  - Të plotësohet projekti me analizë historike të objektit;
  - Të plotësohet projekti në përputhje me kushtet e përcaktuara në V.K.M. Nr. 207, datë 15.03.2017 për “Për shpalljen e Qendrës Historike të qyteti të Korçës dhe miratimin e rregullores për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe Administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth”;
2. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**

Arta DOLLANI

**KRYETAR**

Elda MARGARITI

